TEB
BNP PARIBAS JOINT VENTURE

TEB Sh.A. Zyra Qendrore
Rr. Agim Ramadani nr.15
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 230 000
www.teb-kos.com

Klient i nderuar,

Me këtë letër, TEB SH.A dëshiron t'ju njoftojë se banka ka filluar me procesin e rishikimit dhe freskimit të dosjes së klientëve. Ky rishikim na ndihmon të jemi në pajtueshmëri me rregulloret e brendshme e aplikueshme dhe të aplikojmë kujdes të shtuar më të madh për OJQ-të si dhe të vazhdojmë me ofrimin e shërbimeve më të mira për klientët e bankës në të ardhmen. Si rezultat i kësaj, llogaria(të) juaj bankare është/janë bllokuar.

Për këtë, ju lusim që brenda një jave ta vizitoni degën tuaj të bankës për ta kompletuar dosjen tuaj bankare, ku dokumentet që duhet t'i sillni janë:

1. Dokumentet e regjistrimit të OJQ-së (Certifikata e lëshuar nga Ministria/organi përkatës).
2. Statuti i OJQ-së (ku janë të specifikuara aktiviteti dhe organet e OJQ-së).
3. Dokumentet valide të identifikimit të bashkë-themeluesve dhe personave të autorizuar.
4. Dokumenti për verifikimin e adresës së OJQ-së.
5. Lista e projekteve të realizuara nga OJQ-ja.
6. Dokumenti që dëshmon burimin e financimit të OJQ-së.
7. Nëse organi financues është institucion/organizatë, ju lutem siguroni PPP-në (Pronarin Përfitues Përfundimtar) e institucionit/organizatës.
8. Dokumenti që dëshmon destinacionin përfundimtar të mjeteve.
9. Tri projektet vijuese të planifikuara për t'u realizuar nga OJQ-ja.

Ju informojmë se pas shqyrtimit të të gjitha dokumenteve më sipër, banka do të marrë vendim nëse do të vazhdojë ta mbajë ose jo si klient mbajtës të llogarisë bankare/klient OJQ-në që ju e përfaqësoni. Nëse banka vendosë të mos punojë me OJQ-në që ju e përfaqësoni, Banka do ta mbyllë llogarinë(të) tuaj bankare, që do të rezultojë me ndërprerjen (ose shkëputjen) e shërbimeve bankare. Nëse kjo ndodhë, ju lutem vizitoni degën përkatëse për të tërhequr/transferuar të hollat e depozituara në llogarinë e OJQ-së.

Po ashtu, ju rikujtojmë se mos respektimi i këtij afati mund të përfundojë në mbyllje të llogarisë(ve) suaj bankare që do të rezultojë në ndërprerjen (shkëputjen) e shërbimeve bankare. Nëse kjo ndodhë, ju lutem vizitoni degën përkatëse për të tërhequr/transferuar të hollat e depozituara në llogarinë e OJQ-së.

Nëse keni nevojë për informacione të tjera, ju lutemi vizitoni degën tuaj të bankës.

Ju mirëpresim që të vazhdojmë bashkëpunimin tonë të mëtutjeshëm.

Me nderime,

Dukagjin Shylemaja
Zv. Drejtor Menaxhues

Arif Bibioglu
Zv. Drejtor Menaxhues